

**NDIKIMET POLITIKO-LIGJORE NË FUNKSIONALIZIMIN E
ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE**

TEMA PËR TITULLIN

**MASTER I INTEGRIMEVE EUROPIANE DHE ADMINISTRATËS
PUBLIKE**

NGA

HAKI HURUGLICA



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKE
PRISHTINË**

Korrik 2021

NDIKIMET POLITIKO-LIGJORE NË FUNKSIONALIZIMIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE

Mentor. Prof. Ass. Dr. Adem Beha

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, dëmet eventualisht përfitimet e Kosovës nga kjo marrëveshje. Ndikimin e kësaj marrëveshje në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kushtëzimi i realizimit të kësaj marrëveshje për arritjen e marrëveshjes përfundimtare ndërmjet dy shteteve si dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

PËRMBLEDHJE

Themelimi i Asociacionit së Komunave me Shumicë Serbe është paraparë me Marrëveshjen e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë të arritur me 19 prill, 2013 në Bruksel. Dy vite më vonë, të dyja palët janë pajtuar për themelimin e tij përmes marrëveshjes së 25 gushtit 2015 të quajtur “Asociacioni/Komuniteti i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë-parimet e përgjithshme/elementet kryesore”. Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe parashikohet që të mbledh rreth vetes dhjetë komuna në Kosovë ku shumica e popullsisë janë serbë, të cilat janë Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Partesh, Ranillug, Graçanicë, Zveçan, Zubin Potok, Novobërdë, Leposaviq dhe Shtërpçë.

Siç parashikohet me marrëveshjet përkatëse, Asociacioni ka për qëllim të përfaqësojë interesat kolektive të atyre komunave, në veçanti në fushën e arsimit, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural si dhe të ekonomisë. Marrëveshja fillestare për Asociacionin (e vitit 2013) thekson se Asociacioni do të krijohet me statut dhe strukturat e tij, mbi bazën e statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Pas marrëveshjes së vitit 2013, Kosova dhe Serbia në Bruksel në vitin 2015, nën ndërmjetësimin e BE-së, kanë arritur edhe një marrëveshje shtesë mbi parimet e përgjithëshme për themelimin e Asociacionit. Kjo marrëveshje parasheh se Asociacioni do t'i ketë organet dhe strukturën e vet organizative. Sipas kësaj marrëveshjeje, Asociacioni është paraparë të ketë një kuvend si trup suprem, të përbërë nga përfaqësues të emëruar prej anëtarëve të zgjedhur nga kuvendet e komunave pjesëmarrëse.

Sipas marrëveshjeve në fjalë, Asociacioni do të ketë një president, i cili do ta përfaqësojë Asociacionin pranë autoriteteve qendrore dhe jashtë Kosovës. Asociacioni thuhet se do të punojë me autoritetet qendrore në bazë të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe ndarjes së informatave, si dhe do të promovojë interesat e komunitetit serb të Kosovës në relacionet me autoritetet qendrore. Po ashtu Asociacioni është paraparë që ta ketë buxhetin e tij, i cili do të administrohet në përputhje me parimet e transparencës e llogaridhënies dhe dispozitave të Ligjit mbi prokurimin publik. Pas debateve kontradiktore mes pozitës dhe opozitës, brenda dhe jashtë kuvendit, partitë opozitare deponuan një kërkesë për interpretim të kushtetutshmërisë të marrëveshjes së 25 gushtit, 2015. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës më 23 dhjetor 2015 kishte marrë vendim që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të themelohet ashtu siç është paraparë me Marrëveshjen e parë të Brukselit, të arritur në prill të vitit 2013, në mes të Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, Gjykata kishte konstatuar se parimet e përgjithshme të Asociacionit nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës.

Si përfundim themelimi i Asociacionit mund të kuptohet si presion nga Bashkimi Europian për një zgjidhje afatshkurtër ndërmjet dy vendve, duke u munduar që të arrihë çfarëdo kompromisi që mund të realizohet në mënyrë që të arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke mos menduar pasojat dhe dëmet që mund të ketë themelimi i Asociacionit për demokracinë dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës. Se a do të ketë Asociacioni kompetenca ekzekutive apo jo, në bazë të marrëveshjes nuk është e qartë nëse Asociacioni do të ketë kompetenca ekzekutive por rreziku që të ketë ekziston, në marrëveshjen mbi “Parimet e Përgjithshme” të vitit 2015 në njërin nga objektivat thuhet se “Bashkësia/Asociacioni do të ushtrojë edhe kompetenca tjera shtesë, të cilat mund t’i delegohen nga autoritetet qendrore”, në këtë mënyrë autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës duhet të jenë të kujdesshme që themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe të realizohet brenda kornizës ligjore dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të themelohet në formë të njejtë sikur Asociacioni i Komunave të Kosovës. Themelimi i Asociacionit bazuar në një etni gjithashtu sfidon karakterin shumetnik të Komunave të Kosovës, do të injoronte komunitetet jo-serbe që jetojnë në komunat përkatëse dhe do të shkelte parimin e multi-etnicitetit që shërben si shtyllë e kornizës ligjore të Kosovës nga niveli qendror deri te ai lokal. Asociacioni nuk mund të themelohet në atë mënyrë si një organ që i përfaqëson vetëm interesat e komunitetit serb në Kosovë.

Krijimi me kompetenca ekzekutive i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do të ishte një institucion i cili do të instalonte një autonomi politike dhe territoriale për serbët e Kosovës. Ky Asociacion paraqet një kërcënim të drejtëpërdrejtë të rendit kushtetues, krijon një pushtet të tretë, i cili mund të kërcënojë rendin kushtetues dhe sovranitetin territorial të Republikës së Kosovës. Themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe me kompetenca ekzekutive do të ishte një rrezik më i madh për Republikën e Kosovës, për shkak se do të forconte ndikimin e Qeverisë Serbe në komunat me shumicë serbe. Çdo statut i ardhshëm i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe duhet të përfshijë një kompromis të pranueshëm për të dyja palët, por pala kosovare në asnjë mënyrë nuk duhet të pranojë që Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe të ketë kompetenca ekzekutive. Deri tani autoritetet kosovare nuk e kanë në kontrollin e duhur pjesën veriore të Kosovës dhe themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe me kompetenca ekzekutive veq se do ta zvogëlonte edhe më shumë kontrollin e asaj pjese nga autoritete qendrore të Republikës së Kosovës.

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E KAPITUJVE

Kapitulli i parë të këtij hulumtimi përfshin kornizën ligjore të vetëqeverisjes lokale, ligjin për vetëqeverisjen lokale në Kosovë, bashkëpunimin ndërmjet komunave si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale.

Në kapitullin e dytë flasim për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, mbi kontekstin e dialogut, si është zhvilluar deri tani dialogu ndërmjet dy vendeve, po ashtu flasim edhe për mangësitë dhe devijimet e dialogut.

Kapitulli i tretë, përmban marrëveshjet e nënshkruara nga palët, të metat dhe defektet juridike të marrëveshjeve, zbatimin dhe moszbatimin e atyre marrëveshjeve.

Në kapitullin e katërt flasim për përmbajtjen e marrëveshjes së parë të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, të vitit 2013 dhe përmbajtjen e marrëveshjes për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe mbi parimet e përgjithshme, të vitit 2015.

Në kapitullin e pestë analizohen kompetencat që do të ketë Asociacioni, statutin e tij, autonominë institucionale, koordinimin me autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës, krizën që shkaktoi marrëveshja si dhe ndikimin legjislativ që do ta ketë themelimi i Asociacionit.

Në kapitullin e gjashtë flasim për planin Ahtisari, ligjin për ratifikimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve të dy vendeve, kushtetueshmërinë e Asociacionit, vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, konkluzën e Gjykatës Kushtetuese të Serbisë si dhe qëndrimin e Bashkësisë Ndërkombëtare për Asociacionit e Komunave me Shumicë Serbe.

METODOLOGJIA

Si fillim, për përgatitjen e kësaj teme është përdorur metoda hulumtuese, që konsiston në gjetjen dhe përzgjedhjen e materialeve të duhura për realizimin e këtij punimi shkencor. Sigurisht që këto materiale janë përzgjedhur me kujdes, për të qenë jo vetëm në përputhje me objektin e studimit, por edhe materiale cilësore. Trajtimi kësaj teme është bazuar poashtu mbi metodat përshkruese dhe analizuese të studimeve, punimeve shkencore dhe artikujve. Kam përdorur edhe metodën krahasuese ku kam krahasuar kompetencat e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe kompetencat që i jepen sipas marrëveshjes Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe si dhe vendimet e Gjykatave Kushtetuese të Kosovës dhe Serbisë mbi marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me shumicë Serbe.

Hulumtimi synon të jap përgjigje në pyetjet hulumtuese:

- P.1: Cili do të jetë roli i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe?
- P.2: A do ketë Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe kompetenca ekzekutive?

Anton Vukpalaj


Adem Beha

